VENDIM
Nr. 388, datë 3.5.2017

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË 18 QERSHORIT 2017, DHE FINANCIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE PËRKATËSE PJESËMARRËSE NË KËTO ZGJEDHJE, SI EDHE PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR TË BASHKISË KAVAJË, TË 7 MAJIT 2017

(Ndryshuar me VKM Nr. 762, datë 20.12.2017)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 86, pika 2, e 87, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", si dhe të vendimit nr. 51/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, t'i shtohet fondi *prej 58 000 000 (pesëdhjetë e tetë milionë) lekë*, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 18 qershor 2017.

2. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 18 qershor 2017, t'i jepet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, i cili t'u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në këto zgjedhje, në programin "Mbështetje për partitë politike".

3. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, t'i shtohet fondi prej 7 290 000 (shtatë milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh, për organizimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar të Bashkisë Kavajë, të datës 7 maj 2017.

4. Efekti financiar prej *130 290 000 (njëqind e tridhjetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë*, i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi